



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 755 Akti

Nr. 769 Vendimi
Tiranë, më 31.5.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Xhensila Pine	Kryesuese
Genta Tafa (Bungo)	Relatore
Roland Ilia	Anëtar

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, në datën 31.5.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Enida Lamçe**, ndihmëse ligjore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Genta Tafa (Bungo), vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
2. Znj. Enida Lamçe, aktualisht me detyrë ndihmëse ligjore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, është subjekt rivlerësimi që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni), në datën 15.6.2021, zhvilloi procedurën e shpërndarjes me short të çështjeve në trupa gjykues, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit Enida Lamçe do t'i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Genta Tafa (Bungo), Roland Ilija dhe Xhensila Pine. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionerja Genta Tafa (Bungo).
4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 2.7.2021 u caktua me mirëkuptim kryesuese znj. Xhensila Pine, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.
5. Në referim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit Enida Lamçe nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.
6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV “Vlerësimi i pasurisë” të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimi deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.
7. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V “Kontrolli i figurës” të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.
8. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI “Vlerësimi i aftësive profesionale” të ligjit nr. 84/2016, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.
9. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe

Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK); Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ). Këto raporte janë administruar nga relatorja me fillimin e hetimit administrativ.

10. Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dërgoi raportin¹ e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Enida Lamçe. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin²;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

11. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, AKSIK-ja ka dërguar raportin³ e saj për subjektin e rivlerësimit, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Enida Lamçe.

12. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar, në zbatim të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, një raport⁴ të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

13. Në vijim, relatorja e çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; vlerësimi i aftësive profesionale.

14. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 21.5.2024 vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret për subjektin e rivlerësimit; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes.

15. Subjekti i rivlerësimit në datën 21.5.2024 u njoftua mbi të drejtën e saj për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkonte marrjen e provave të reja ose thirrjen e dëshmitarëve lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i

¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 27.3.2018.

² Nisur nga mungesa e argumentimit për këtë, në raport vlerësohet se ky konkluzion i ILDKPKI-së mund të jetë një lapsus.

³ Raport nr. *** prot., datë 2.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 14.10.2023, të KDZH-së.

⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 7.2.2023.

rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 22.5.2024, ndërsa më 27.5.2024 ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja në përgjigje të rezultateve të hetimit.

16. Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore⁵.

II. SEANCA DËGJIMORE

17. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore publike me njoftimin e bërë elektronikisht me *email*, në datën 28.5.2024.

18. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 31.5.2024, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova.

19. Subjekti i rivlerësimit Enida Lamçe mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

20. Znj. Enida Lamçe ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke u përgjigjur në kohë, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

20.1 Subjekti i rivlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekte dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancave dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

21. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

21.1 Referuar vendimit nr. 2/2017⁶ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni në kryerjen e funksionit të tij kushtetues realizon një proces të mirëfilltë

⁵ Vendim i ndërmjetëm nr. 3, datë 28.5.2024.

⁶ “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

22. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) provat shkrese/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (d) raportet e kontrollit të figurës të dorëzuar pranë Komisionit nga AKSIK-ja; (dh) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar pranë Komisionit nga KLGJ-ja; (e) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike.

A. VLERËSIMI I PASURISË

23. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si dhe në burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive.

23.1 Subjekti i rivlerësimit ka filluar detyrën si ndihmëse ligjore në datën 8.6.2015 pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

23.2 Në deklaratën *Vetting* (shtojca 2), të dorëzuar në ILDKPKI në datën 27.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar se zotërojnë pasuritë si vijon:

24. Llogari rrjedhëse pranë Bankës Kombëtare Tregtare⁷, me gjendje në datën 26.1.2017 në vlerën 50,000 lekë. Pjesa takuese: 100%.

Burimi sipas deklaratës *Vetting*: të ardhura nga paga.

Hetimi⁸/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

25. Nga nxjerrjet e llogarisë bankare pranë Bankës Kombëtare Tregtare rezulton se në datën 3.4.2012 subjekti ka hapur llogarinë rrjedhëse nr. ***, në lek.

25.1 Në këtë llogari rezulton të jenë derdhur pagat për periudhën 2012 e në vazhdim. Gjendja e llogarisë bankare deri më 26.1.2017 rezulton të jetë 50,000 lekë.

25.2 Nga hetimi i kryer nuk kanë lindur dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë llogari bankare të subjektit. Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar.

26. Gjendje *cash* në shumën 300,000 lekë

Burimi sipas deklaratës *Vetting*: të ardhurat e krijuara nga paga dhe si pjesë takuese subjekti ka deklaruar 50% të bashkëshortit dhe 50% në emër të saj.

Hetimi/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

⁷ Nxjerrje llogarie bankare datë 26.1.2017 në BKT.

⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 8.9.2021, drejtuar BKT-së; kthim përgjigje nr. *** prot., datë 27.9.2021, nga BKT-ja.

27. Komisioni ka kryer analizën financiare lidhur me mundësinë për krijimin e gjendjes *cash* prej 300,000 lekësh, të deklaruar nga subjekti.

Tabela nr. 1 – Analiza financiare

Periudha	8.6.2015 deri në deklaratën <i>Vetting</i>
Pasuria	534,321.25
<i>Ndryshim likuiditeti</i>	<i>534,321.25</i>
Detyrime	0.00
Pasuria neto	534,321.25
Të ardhura	3,677,574.64
Të ardhurat e subjektit	1,187,147.00
Të ardhurat e bashkëshortit të subjektit	1,361,074.64
Të ardhurat e babait të bashkëshortit të subjektit, pension	453,195.00
Të ardhurat e nënës së bashkëshortit të subjektit, pension	676,158.00
Shpenzime	2,311,773.61
Shpenzime jetike	2,045,185.35
TIMS	266,588.25
Mundësia për kursime	831,479.78

27.1 Në kushtet që subjekti ka depozituar vetëm deklaratën *Vetting*, analiza është bërë kumulative dhe në të janë përfshirë:

- i) të ardhurat e subjektit dhe të bashkëshortit për periudhën 8.6.2015 deri në deklaratën *Vetting*;
- ii) të ardhurat e prindërve të bashkëshortit për periudhën 8.6.2015 – 13.9.2016, datë kur ka përfunduar edhe bashkëjetesa me ta;
- iii) shpenzimet jetike për periudhën e bashkëjetesës me prindërit e bashkëshortit janë përlllogaritur për 6 persona dhe prej datës 13.9.2016 e në vazhdim për 4 persona. Shpenzimet TIMS 1,964 euro.

27.2 Në përfundim të hetimit konkludohet se subjekti dhe personat e lidhur me të kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e gjendjes *cash* në vlerën 300,000 lekë.

28. **Kartë krediti MC Classic⁹**, me limit 60,000 lekë pranë BKT-së. Shuma e detyrimit të mbetur është 16,308.88 lekë.

Hetimi¹⁰/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

29. Nga nxjerrjet e llogarisë bankare pranë BKT-së rezulton se znj. Enida Lamçe është mbajtëse e kartës së kreditit me limit 60,000 lekë. Detyrimi i mbetur deri në datën 27.1.2017 është 16,303.88 lekë.

29.1 Nga hetimi nuk rezulton ndonjë paqartësi në lidhje me këtë llogari bankare. Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar.

PASURITË E BASHKËSHORTIT TË SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Referuar të dhënave të dërguara nga Zyra e Gjendjes Civile, Njësia Bashkiake Nr. *, Tiranë, për vitin 2010 rezulton se subjekti i rivlerësimit figuron në gjendje civile me status “e martuar” me shtetasin B.L. Në deklaratën *Vetting*, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar këto pasuri:

⁹ Subjekti ka depozituar Printim i Llogarisë kartë krediti, datë 26.1.2017.

¹⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 8.9.2021 drejtuar BKT-së; kthim përgjigje nr. *** prot., datë 27.9.2021, nga BKT-ja.

30. Automjet tip “Mercedes-Benz”¹¹, blerë me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., në datën 21.3.2015. Vlera: 200,000 lekë. Pjesa takuese: 100% .

Burimi sipas deklaratës *Vetting*: të ardhura nga paga.

Hetimi¹²/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

31. Në datën 21.3.2015, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka blerë automjetin tip “Daimler Chrysler” me kontratën nr. ***, në vlerën 200,000 lekë.

31.1 Nga hetimi ka rezultuar se ky automjet është shitur me kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 19.5.2020, pranë DRSHTRR-së Tiranë, në vlerën 250,000 lekë.

31.2 Komisioni ka kryer analizën financiare lidhur me mundësinë për blerjen e pasurisë automjet tip “Mercedes-Benz”, datë 21.3.2015.

Tabela nr. 2 – Analiza financiare

	Automjet, datë 21.3.2015
Pasuria	-200,961.59
Automjet “Mercedes-Benz”, datë 21.3.2015	200,000.00
<i>Ndryshim likuiditeti</i>	<i>-400,961.59</i>
Detyrime	0.00
Pasuria neto	-200,961.59
Të ardhura	252,115.00
Të ardhurat e subjektit	144,907.00
Të ardhurat e bashkëshortit të subjektit	107,208.00
Shpenzime	336,414.00
Shpenzime jetike	336,414.00
TIMS	0.00
Mundësia për kursime	116,662.59

31.3 Në analizën financiare janë përfshirë:

- të ardhurat e subjektit dhe bashkëshortit të saj sipas nxjerrjeve të llogarive bankare;
- shpenzimet jetike janë përlllogaritur për 6 persona.

31.4 Në përfundim, në lidhje me këtë pasuri nuk lindin dyshime apo paqartësi. Subjekti dhe personat e lidhur me të kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e saj.

32. Llogari rrjedhëse pranë Societe Generale Albania¹³, me gjendje në datën 26.1.2017 në vlerën 78,253.06 lekë. Pjesa takuese: 100%.

Burimi sipas deklaratës *Vetting*: të ardhura nga paga.

Hetimi¹⁴/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

¹¹ Subjekti ka depozituar: (i) certifikatë pronësie të mjetit me targë AA *** AK, datë 1.4.2015; (ii) kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 21.3.2015; (iii) faturë doganore datë 1.2.2010; (iv) urdhër çlirimi datë 1.2.2010; (v) dokument hyrjeje, leje qarkullimi provizore nr. *** prot., datë 20.10.2020; (vi) kontratë shitjeje mjeti nr. ***, datë 7.8.2014.

¹² Shkresë nr. *** prot., datë 8.9.2021, drejtuar DPSHTRR-së; kthim përgjigjeje nr. ***, datë 17.9.2021, nga DPSHTRR-ja.

¹³ Subjekti ka depozituar lëvizjet e llogarisë në Societe Generale Albania, në datën 26.1.2017.

¹⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 8.9.2021, drejtuar OTP-së; kthim përgjigjeje nr. ***-tbo-***, datë 3.12.2021, nga OTP-ja.

33. Nga nxjerrjet e llogarisë bankare pranë OTP Bank rezulton se në datën 30.4.2010 bashkëshorti i subjektit ka hapur pranë ish-Societe Generale Albania llogarinë rrjedhëse nr. ***ALL***, në lek.

33.1 Në këtë llogari për periudhën prill 2010 e në vazhdim rezulton të jenë derdhur pagat e përfituara nga punësimi në shoqërinë “A” sh.a. dhe për periudhën dhjetor 2015 e në vazhdim edhe pagat e përfituara nga punësimi në shoqërinë “A” sh.a .

33.2 Në datën 26.1.2017 rezulton që gjendja e llogarisë të jetë në shumën 77,903.06 lekë.

33.3 Në përfundim, nuk rezulton ndonjë paqartësi në lidhje me këtë llogari bankare. Deklarimi i bashkëshortit të subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar.

34. Llogari rrjedhëse pranë Bankës Kombëtare Tregtare¹⁵, me gjendje në datën 26.1.2017 në vlerën 0 (zero) lek. Pjesa takuese: 100%.

Burimi sipas deklaratës *Vetting*: të ardhurat nga pagat.

Hetimi¹⁶/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

35. Nga nxjerrjet e llogarisë bankare pranë BKT-së rezulton se në datën 3.11.2014 bashkëshorti i subjekti ka hapur llogarinë rrjedhëse nr.***, në lek.

35.1 Në këtë llogari rezulton të jenë derdhur pagat për periudhën 2018 e në vazhdim.

35.2 Në datën 26.1.2017, gjendja e llogarisë rezulton të jetë 0 (zero).

35.3 Në përfundim, nuk rezulton ndonjë paqartësi në lidhje me këtë llogari bankare. Deklarimi i bashkëshortit të subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar.

36. Subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë deklaruar në deklaratën *Vetting* të ardhurat si vijon:

- nga paga neto, të fituara nga ushtrimi i detyrës si ndihmëse ligjore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë¹⁷ nga data 8.6.2015 deri më 31.12.2016, shuma neto 1,186,147 lekë;
- nga paga neto e bashkëshortit¹⁸, të fituara nga ushtrimi i detyrës pranë departamentit të financës në shoqëritë “A” sh.a. dhe “A” sh.a., për periudhën qershor 2015 – 31.12.2016, shuma neto 1,321,904 lekë;
- nga angazhimi në organizatën jofitimprurëse K.Sh i H¹⁹, shuma neto 221 USD.

Hetimi²⁰/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

37. Nga nxjerrjet e llogarive bankare pranë ProCredit Bank nr. *** dhe nr. *** të subjektit, rezulton se ajo ka përfiturar të ardhura nga paga të kredituara në këto llogari si sekretare

¹⁵ Subjekti ka depozituar nxjerrje llogarie në BKT, datë 27.1.2017.

¹⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 8.9.2021, drejtuar BKT-së; kthim përgjigjeje nr. ***prot., datë 27.9.2021, nga BKT-ja.

¹⁷ Vërtetim nr. *** prot., janar 2017, nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë; vërtetim nr. *** prot., tetor 2016, lëshuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, për periudhën nëntor 2013 – maj 2015.

¹⁸ Tri vërtetime të datës 20.1.2017, lëshuar nga shoqëritë “A” sh.a. dhe “A” sh.a., për periudhën 2014 – 2016.

¹⁹ Vërtetim nr. ** prot., datë 27.1.2017, lëshuar nga K i H, ku vërtetohet se subjekti i rivlerësimit Enida Lamçe ka marrë pjesë si eksperte për monitorimin e zgjedhjeve të pjesshme në Bashkinë e Dibrës, në vitin 2016.

²⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 8.9.2021, drejtuar BKT-së; kthim përgjigjeje nr. ***prot., datë 27.9.2021, nga BKT-ja; shkresë nr. *** prot., datë 8.9.2021, drejtuar ProCredit Bank; kthim përgjigjeje nr. OP-*** prot., datë 22.9.2021, nga ProCredit Bank; shkresë nr. *** prot., datë 8.9.2021, drejtuar Tirana Bank; kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 10.9.2021, nga Tirana Bank.

gjqësore pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për periudhën maj 2007 – shtator 2008 dhe të ardhura nga paga si specialiste në Njësinë Bashkiake Nr. *, Tiranë, për periudhën shtator 2008 – prill 2012, në shumën totale 1,675,285 lekë.

38. Nga nxjerrjet e llogarisë bankare pranë BKT-së nr. ***, në lek, rezulton se subjekti ka përfituar të ardhura nga paga të kredituara në këtë llogari si sekretare gjyqësore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për periudhën nëntor 2013 – qershor 2015 dhe si ndihmëse ligjore pranë kësaj Gjykate për periudhën qershor 2015 e në vazhdim, në shumën totale 2,492,234 lekë.

39. Nga nxjerrjet e llogarisë bankare pranë Tirana Bank të bashkëshortit të subjektit, rezulton se ai ka përfituar të ardhura nga paga të kredituara në këto llogari për periudhën shtator 2007 – mars 2010, në shumën totale 712,832 lekë.

40. Nga nxjerrjet e llogarisë bankare pranë OTP Bank të bashkëshortit të subjektit, rezulton se ai ka përfituar të ardhura nga paga të kredituara në këto llogari për periudhën prill 2010 – shtator 2018 si i punësuar pranë shoqërisë “A” sh.a, dhe për periudhën dhjetor 2015 – shtator 2018 nga pagat pranë shoqërisë “A” sh.a., në shumën totale 3,947,648.93 lekë.

41. Në analizën financiare janë përfshirë të ardhurat e subjektit dhe bashkëshortit të saj të kredituara në llogaritë bankare, të cilat nga fillimi i detyrës deri në deklaratën *Vetting* rezultojnë të jenë në shumën totale 2,548,221.64 lekë.

Në përfundim, nuk ka paqartësi në lidhje me përfitimin e këtyre të ardhurave nga subjekti dhe personat e lidhur me të. Deklarimi përputhet me dokumentacionin e administruar.

42. Në lidhje me adresat e banimit

42.1 Në pyetësorin standard, subjekti ka deklaruar: *“Që nga momenti që kam marrë detyrën për herë të parë në datën 8.6.2015, kam banuar në adresën Njësia Administrative Nr. *, rruga “Nj.M”, banesë private nr. ***, A (rrugica “S.Z”), Tiranë. Pronari i kësaj banese është babai i bashkëshortit Y.L dhe nuk kam paguar asnjëherë qira... Në datën 4.12.2018, bashkëshorti dhe unë në cilësinë e kredimarrësve kemi lidhur kontratë kredie bankare hipotekore me BKT sh.a. Banka ka akorduar në favorin tonë shumën prej 3,000,000 lekësh në funksion të ndërtimit shtesë kati të pronës, e cila është regjistruar në emër të vjehrrit tim Y. L (banesë ku aktualisht banojmë unë me bashkëshortin dhe fëmijët). Kjo shumë është transferuar nga banka në llogarinë e bashkëshortit tim, e cila është tërhequr nga ai në kohë të ndryshme dhe përdorur në favor të zhvillimit të pronës të vjehrrit... Në datën 14.2.2019, unë me bashkëshortin në cilësinë e kredimarrësve kemi lidhur kontratë kredie me BKT-në për lëvrimin e shumës 1,000,000 lekë në favor të zhvillimit të pronës së lartpërmendur... Në datën 7.6.2021, unë me bashkëshortin në cilësinë e kredimarrësve kemi lidhur kontratë kredie me BKT-në për lëvrimin e shumës 1,100,000 lekë. Në datën 8.6.2021 kam paguar shumën 581,550.68 lekë për mbylljen e kredisë ekzistuese pranë BKT-së. Burimi financiar është kredia e marrë në datën 7.6.2021, në shumën 1,100,000 lekë, me të cilën kam mbyllur kredinë ekzistuese në shumën 581,550.68 lekë dhe shumën e mbetur e kam tërhequr dhe e kam përdorur në vazhdimësi në kohë të ndryshme për blerje në funksion të shtëpisë, kryesisht elektroshtëpiake dhe pushime”.*

Hetimi²¹/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

²¹ Subjekti me pyetësorin standard ka depozituar: certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, lëshuar në datën 26.8.2020, nga ku rezulton se shtetasi Y.J.L është pronar i pasurisë nr. ***, zona kadastrale ***, lloji i pasurisë

43. Referuar dokumentacionit të dërguar nga ASHK-ja, si dhe materialeve të dokumentacionit pjesë e dosjes së ILDKPKI-së, rezulton se shtetasi Y.J.L të jetë pajisur me certifikatë pronësie datë 24.12.2015, për pasurinë truall nr. ***, ndodhur në zonën kadastrale nr. ***, me sipërfaqe truall 204.50 m² dhe sipërfaqe totale 204.50 m², me pjesë takuese 100%.

44. Lidhur me këtë pasuri, rezulton se shtetasi Y.J.L ka qenë posedues i objektit të banimit, me adresë Njësia Administrative Nr. *, vlera e investimit 96.6 m² * 29,910 lekë/m², në total 2,889,306 lekë, për të cilën figuron aplikues për legalizim të ndërtimeve pa leje Form A, nr. ** prot., datë 15.3.2005, Njësia Administrative Nr. *, Tiranë. Në datën 21.3.2013, shtetasi Y.L është pajisur me leje legalizimi nr. *** për godinë banimi 1 kat nga ASHK Tirana Veri, referuar edhe kontratës noteriale për kalimin e pronësisë nr. ** rep., nr. **kol., datë 10.1.2013, lidhur me Drejtorinë e ALUIZNI-t Tirana 1.

45. Në përfundim të hetimit, Komisioni konstaton se pasuria e llojit truall me nr. ***, zona kadastrale ***, sip. 204.50 m², nga kjo ndërtesë me sip. 96.60 m², krijuar nga babai i bashkëshortit të subjektit, shtetasi Y.L, në vitin 2005, nuk është objekt vlerësimi i Komisionit, pasi kjo nuk është një pasuri e subjektit apo e bashkëshortit të saj. Gjithashtu, për periudhën në të cilën është krijuar kjo pasuri, subjekti nuk ka qenë e martuar, si dhe nuk ka qenë në detyrë. Ndërkohë, Komisioni ka kryer një hetim të plotë për shtesën e ndërtuar mbi këtë pasuri, e cila sipas deklarimeve të subjektit është krijuar nga ana e saj.

Hetimi në lidhje me shtesën

46. Në datën 26.9.2018, shtetasi Y.L rezulton të jetë pajisur me leje ndërtimi nr. A*** prot., për “Shtesë në objektin ekzistues 1 kat, sipërfaqja e katit të parë 64 m²”, për të cilën kishte lidhur kontratën noteriale të sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 31.1.2018, me shoqërinë ndërtuese “S” sh.p.k., të përfaqësuar nga administratorët e shoqërisë Sh.N dhe F.S. Vlera e punimeve sipas preventivit është 2,843,729 lekë. Ky objekt shërben si banesë aktuale e subjektit të rivlerësimit Enida Lamçe dhe familjarëve të saj.

47. Në datën 30.6.2019, shtetasi Y.L përmes mandarit nr. *** ka kryer pagesë për subjektin “S” sh.p.k., në vlerën 3,148,720 lekë, me përshkrimin “Situacion punimesh Y.L qershor...”.

48. Në datën 26.8.2020 rezulton se shtetasi Y.J.L është pajisur me certifikatë pronësie me pjesë takuese 100%, për pasurinë e llojit truall me nr. ***, vol. ** f. ***, z. k. ***, me sipërfaqe totale 204.50 dhe sipërfaqe truall 204/5, nga këto sipërfaqe ndërtimi 96.60 m², dokumentuar me foto të zhvillimit të kësaj pasurie.

Në lidhje me kreditë bankare të marra nga subjekti dhe personat e lidhur me të pranë BKT-së

49. Në lidhje me burimin për shtesën e ndërtuar, subjekti ka deklaruar në pyetësin standard se si burim kanë shërbyer kredi të marra pranë Bankës Kombëtare Tregtare.

50. Nga hetimi ka rezultuar se:

truall me sip. 204.50 m², nga kjo ndërtesë 96.60 m²; kartelë pasurie nr. ***, zona kadastrale ***, lloji i pasurisë truall me sip. 204.50 m², nga kjo ndërtesë 96.60 m², ku në seksionin “Përshkrim i veçantë” citohet: “Objekt banimi 2 kat; kati përdhe 96.6 m², leje legalizimi; kati i parë 64 m², leje ndërtimi, leje legalizimi nr. *** datë 1.3.2013, leje ndërtimi nr. A-*** prot., datë 26.9.2018, për objektin ekzistues 1 kat, sipërfaqe e katit të parë 64 m²”.

a. Subjekti dhe bashkëshorti i saj B.L janë bashkëkredimarrës me kontratë kredie bankare konsumatore nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.12.2018, sipas së cilës iu është akorduar kredi në vlerën 3,000,000 lekë, me qëllim ndërtim banese, me këst mujor 46,194.75 lekë.

Kjo kredi është siguruar me kontratën e hipotekimit nr. *** rep., nr *** kol., datë 4.12.2018, me garanci të përfaqësuar nga hipotekimi i pasurisë së paluajtshme truall + ndërtesë, me sipërfaqe trualli 204.5 m² dhe ndërtesë 96.6 m², në emër të shtetasit Y.L, me pjesë takuese 100%, e regjistruar në datën 24.12.2015 në regjistrin hipotekor me nr. pasurie ***, vol. **, f. **, z. k. ***, me adresë rruga “* M”, Tiranë.

Kredia është disbursuar në llogarinë nr. ***, datë 12.12.2018, të bashkëshortit të subjektit, z. B.L dhe tërheqjet e kredisë nga bashkëshorti i subjektit janë si vijon:

- në datën 13.12.2018, B.L ka tërhequr shumën 500,000 lekë;
- në datën 19.12.2018, B.L ka tërhequr shumën 500,000 lekë;
- në datën 10.1.2019, B.L ka tërhequr shumën 500,000 lekë;
- në datën 1.2.2019, B.L ka tërhequr shumën 200,000 lekë;
- në datën 4.2.2019, B.L ka tërhequr shumën 150,000 lekë;
- diferenca e shumës së mbetur prej 1,150,000 lekësh është tërhequr nga shtetasi B.L në vlera të vogla në mënyrë periodike nga data e disbursimit dhjetor 2018 deri në shkurt 2019.

Për sa më sipër, rezulton se kjo kredi ka shërbyer për pagesën e ndërtimit të shtëpisë, duke qenë se pagesa përfundimtare për llogari të shoqërisë “S” sh.p.k. është bërë në datën 30.6.2019.

b. Subjekti dhe bashkëshorti i saj B.L janë bashkëkredimarrës me kontratë kredie konsumatore të datës 14.2.2019, sipas së cilës iu është akorduar kredi në vlerën 1,000,000 lekë, me qëllim mobilim shtëpie, me këst mujor 18,872.74 lekë.

Kredia është disbursuar në llogarinë e subjektit nr. ***, datë 19.02.2019 dhe tërheqjet e kredisë janë kryer nga subjekti në mënyrë pjesore periodike nga data e disbursimit dhe deri në prill të vitit 2019.

Shlyerja e kësaj kredie është kryer nga subjekti në mënyrë periodike mujore deri në datën 8.6.2021, në të cilën ka bërë mbyllje të parakohshme të kësaj kredie nëpërmjet kredisë konsumatore të disbursuar në datën 7.6.2021 në këtë llogari, në shumën 1,100,000 lekë.

c. Subjekti dhe bashkëshorti i saj B.L janë bashkëkredimarrës me kontratë kredie konsumatore të datës 2.6.2021, sipas së cilës iu është akorduar kredi në vlerën 1,100,000 lekë, me qëllim për mbyllje kredie ekzistuese dhe diferenca për mobilim shtëpie, me këst mujor 18,872.74 lekë.

- Kredia është disbursuar në llogarinë e subjektit nr. ***, datë 7.6.2021.
- Në datën 8.6.2021, subjekti ka bërë mbyllje të parakohshme të kredisë konsumatore të datës 14.2.2019, në shumën 581,550 lekë, komisione për mbyllje të parakohshme të kredisë 7,563.97 lekë.
- Në datën 18.6.2021, subjekti ka kryer tërheqje të shumës 500,000 lekë.
- Shlyerja e kësaj kredie është kryer nga subjekti në mënyrë periodike mujore.

51. Nga sa më sipër, lidhur me objektin “Kati i parë me sipërfaqe 64 m², ndodhur në pasurinë nr. ***, zona kadastrale ***, sip. 204.50 m²”, e cila figuron e regjistruar në emrin e shtetasit Y. L, rezulton e provuar se kreditë e akorduara nga BKT-ja në emër të subjektit Enida Lamçe dhe

bashkëshortit të saj janë përdorur për ndërtimin dhe zhvillimin e kësaj pasurie, e cila shërben si banesë aktuale e subjektit të rivlerësimit.

52. Në përfundim, rezulton se subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për ndërtimin e objektit me sipërfaqe 64 m².

53. Komisioni ka kryer një analizë të plotë financiare për subjektin nga fillimi i detyrës datë 8.6.2015 deri në deklaratën *Vetting*.

Tabela nr. 3

Periudha	8.6.2015 deri në deklaratën <i>Vetting</i>
Pasuria	404,755.16
Automjet “Mercedes-Benz”, viti 2015	0.00
<i>Ndryshim likuiditeti</i>	<i>404,755.16</i>
Detyrime	0.00
Pasuria neto	404,755.16
Të ardhura	3,677,574.64
Të ardhurat e subjektit	1,187,147.00
Të ardhurat e bashkëshortit të subjektit	1,361,074.64
Të ardhurat e babait të bashkëshortit të subjektit	453,195.00
Të ardhurat e nënës së bashkëshortit të subjektit	676,158.00
Shpenzime	2,311,773.61
Shpenzime jetike	2,045,185.35
TIMS	266,588.25
Mundësia për kursime	961,045.87

54. Në kushtet që subjekti ka depozituar vetëm deklaratën *Vetting*, analiza është bërë kumulative nga data 8.6.2015 deri në deklaratën *Vetting* dhe në të janë përfshirë:

- të ardhurat e subjektit dhe bashkëshortit sipas nxjerrjeve të llogarive bankare;
- të ardhurat e prindërve të bashkëshortit vetëm për periudhën 8.6.2015 – 13.9.2016, datë kur ka përfunduar edhe bashkëjetesa me ta;
- shpenzimet jetike për periudhën e bashkëjetesës me prindërit e bashkëshortit janë përlllogaritur për 6 persona dhe prej datës 13.9.2016 e në vazhdim për 4 persona;
- shpenzimet TIMS.

55. Në përfundim të analizës financiare prej fillimit të detyrës deri në deklaratën *Vetting*, duket se subjekti dhe personat e lidhur me të kanë pasur mundësi financiare për të mbuluar shpenzimet e kryera prej tyre gjatë kësaj periudhe.

Konkluzion i Komisionit për vlerësimin e pasurisë

56. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht, si dhe ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht në deklaratën *Vetting* pasuritë e saj dhe të personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

57. Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së saj. Nga hetimi ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, zotërim ose në përdorim të saj. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit Enida Lamçe nuk vërtetohen shkaqet që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatoheshin parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

58. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Enida Lamçe ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

59. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Enida Lamçe me anë të verifikimit të deklaramëve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

60. Për këtë qëllim, AKSIK-ja ka dërguar në Komision raportin²² mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Enida Lamçe, ku ka konstatuar se: (i) formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës; (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

61. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, AKSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit.

62. Komisioni kreu një hetim²³ të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetin e subjektit të rivlerësimit Enida Lamçe. Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e saj në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Konkluzion i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës

63. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Enida Lamçe ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

64. Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni është bazuar në:

- raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga KLGJ-ja;
- kriteret e vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 84/2016, neni 42, pika 2, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 49/2012, neni 6, pikat 1 dhe 2, “Për organizmin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

²² Raporti nr. *** prot., datë 2.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 14.10.2022, të KDZH-së.

²³ Shihni dosjen me informacion të klasifikuar të subjektit të rivlerësimit.

Raporti i hartuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor

65. Ky raport është përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në ligjin nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

66. Hartimi i këtij raporti është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: formularit të vetëdeklarimit, tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit; pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së.

67. Raporti ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit: (a) aftësitë profesionale; (b) aftësitë organizative; (c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; (ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

68. Nga verifikimi i tri dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve të përzgjedhura me short, të depozituara nga subjekti, nuk u konstatuan problematika lidhur me vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit Enida Lamçe, në cilësinë e ndihmëses ligjore.

69. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur 3 dokumente, 3 projektvendime përfundimtare.

Një dokument i përket vitit 2015, ndërsa dy dokumente të tjera ligjore i përkasin vitit 2016 gjatë ushtrimit të detyrës si ndihmëse ligjore.

Dokumenti 1 – Projektvendim për çështjen administrative nr. *** regj., datë 23.9.2015, që u përket palëve ndërgjyqëse: paditëse V. L kundër të paditurit Instituti i Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor Tiranë, me objekt “Konstatimi i pavlefshmërisë absolute të Urdhrit të Drejtores së Përgjithshme të ISKSH-së me nr. ***, datë 22.5.2013 etj.”.

Ky dokument ligjor i përket çështjes administrative të listuar në tabelat statistikore të gjyqtarës N. H, me nr. rendor ***, e përfunduar sipas tabelës statistikore më 29.10.2015.

Nga struktura e projektvendimit vërehet se ai përbëhet nga tri pjesë, sipas kërkesave të ligjit procedural: hyrëse, përshkruese-arsyetuese dhe dispozitivi i vendimit. Në pjesën hyrëse janë përshkruar palët ndërgjyqëse, objekti i padisë dhe baza ligjore. Pjesa arsyetuese është e ndarë në dy nënpjesë. Në nënpjesën e parë përshkruese janë parashtruar *fakti dhe rrethanat* për kërkimet e palës paditëse lidhur me objektin e padisë dhe prapësimet e palës së paditur në nxjerrjen e vendimit objekt gjykimi. Po në këtë pjesë janë parashtruar nga ana e ndihmëses ligjore rrethanat e çështjes dhe provat e administruara në dosjen gjyqësore lidhur me kontratën individuale të punës së paditëses me palën e paditur, duke u referuar për këtë tek e drejta e zbatueshme në këto raste. Në nënpjesën e dytë është përshkruar arsyetimi dhe vlerësimi i ndihmëses ligjore për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, ku janë analizuar shkaqet e zgjidhjes së kontratës së punës dhe procedura e ndjekur në këtë rast. Ndihmësja ligjore ka arritur në përfundimin se paditësja si punëmarrëse nuk ka shkelur ndonjë detyrim kontraktual dhe zgjidhja e kontratës nga punëdhënësi është e menjëhershme dhe e pajustificuar. Ndihmësja ligjore ka argumentuar me saktësi në arsyetim detyrimin për masën e dëmshpërblimit për

paditësen, nisur nga kohëzgjatja e marrëdhënieve të punës, afatin e njoftimit për zgjidhjen e kontratës dhe vjetërsinë në punë të saj.

Përmenden dhe analizohen në arsyetim norma të Kodit të Punës, ligjit nr. 49/2012, ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm shëndetësor në Republikën e Shqipërisë” dhe rregulloren e brendshme funksionale të ISKSH-së. Ndhmësja ligjore ka përdorur në arsyetim norma procedurale dhe legjislative.

Nga pikëpamja e strukturës, projektvendimi është i ndarë në paragrafë dhe tituj të evidentuar, sipas analizës së kërkimeve. Konstatohet se janë respektuar rregullat e drejtshkrimit, por nuk janë përdorur të gjitha karakteret e gjuhës shqipe. Fjalitë paraqiten në gjatësi normale dhe përmbajnë referenca ligjore. Teksti paraqitet i qartë dhe i kuptueshëm, në 6 faqe gjithsej. Projektvendimi është konceptuar nga subjekti i rivlerësimit, përmban në fund emrin dhe firmën e saj, por nuk pasqyron datën e përpilimit.

Dokumenti 2 – Projektvendim për çështjen administrative nr. *** regj., datë 4.4.2016, që u përket palëve ndërgjyqëse: paditës F. B kundër të paditurit Këshilli i Qarkut Dibër, me objekt “Shfuqizimi i aktit administrativ, vendimi nr. ***, datë 16.2.2016, i palës së paditur për lirimin nga shërbimi civil. Detyrimin për rikthimin në vendin e mëparshëm të punës etj.”.

Ky dokument ligjor i përket çështjes administrative të listuar në tabelat statistikore të gjyqtarës N. H, me nr. rendor ***, e përfunduar më 27.5.2016.

Nga struktura e projektvendimit vërehet se ai përbëhet nga tri pjesë, sipas kërkesave të ligjit procedural: hyrëse, përshkruese-arsyetuese dhe dispozitivi i vendimit. Në pjesën hyrëse janë përshkruar palët ndërgjyqëse, objekti i padisë dhe baza ligjore e kërkimeve. Pjesa arsyetuese është e ndarë në dy nënpjesë. Në nënpjesën e parë përshkruese janë parashtruar *fakti dhe rrethanat* lidhur me objektin e padisë dhe analiza e pretendimeve të palëve ndërgjyqëse e provave të paraqitura prej tyre. Po në këtë pjesë janë parashtruar nga ana e ndihmëses ligjore të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë rrethanat e çështjes lidhur me shkaqet e zgjidhjes së kontratës së punës të paditësit nga ana e palës së paditur, duke u referuar për këtë tek e drejta e zbatueshme në këto raste. Në nënpjesën e dytë është përshkruar arsyetimi dhe vlerësimi i ndihmëses ligjore për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, ku është analizuar lidhur me shkaqet për zgjidhjen e kontratës së punës të paditësit dhe pasojat që rrjedhin. Ajo ka arritur në përfundimin se paditësi është larguar në mënyrë përfundimtare nga shërbimi civil, për shkak të ristrukturimit të Këshillit të Qarkut Dibër dhe shkurtimit të vendit të tij të punës, prandaj kërkesëpadia është e pabazuar në ligj dhe në prova dhe, si e tillë, duhet rrëzuar.

Përmenden dhe analizohen në arsyetim norma të Kodit të Punës, Kodit të Procedurave Administrative, ligjit nr. 49/2012 “Për organizmin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, ligjit nr. 152/2013, “Për shërbimin civil” dhe VKM-së nr. 171, datë 26.3.2014. Ndhmësja ligjore ka përdorur në arsyetim norma procedurale dhe legjislative.

Nga pikëpamja e strukturës vendimi është i ndarë në paragrafë dhe tituj të evidentuar, sipas analizës së çështjes. Konstatohet se janë respektuar rregullat e drejtshkrimit, por nuk janë përdorur të gjitha karakteret e gjuhës shqipe. Fjalitë paraqiten në gjatësi normale dhe përmbajnë referenca ligjore. Teksti paraqitet i qartë dhe i kuptueshëm, në 7 faqe gjithsej. Projektvendimi është konceptuar nga subjekti i rivlerësimit, përmban në fund emrin dhe firmën e saj, por nuk pasqyron datën e përpilimit.

Dokumenti 3 – Projektvendim për çështjen administrative nr. *** regj., datë s’ka, që u përket palëve ndërgjyqëse: paditës shoqëria “M.G.T” sh.p.k. kundër të paditurit Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë etj., me objekt “Shfuqizimi i pjesshëm i njoftim-vlerësimit për detyrimet tatimore nr. ***, datë 26.9.2015, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, për gjobën me vlerë 500,000 lekë, si dhe shfuqizimin e vendimit nr. *** prot., datë 16.11.2015, të Drejtorisë së Apelimit Tatimor, si të pabazuar në ligj e në prova”.

Ky dokument ligjor nuk pasqyrohet i listuar në tabelat statistikore të gjyqtarëve B. K e N. H, pasi gjykimi i çështjes ka përfunduar jashtë periudhës së rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016.

Nga struktura e projektvendimit vërehet se ai përbëhet nga tri pjesë, sipas kërkesave të ligjit procedural: hyrëse, përshkruese-arsyetuese dhe dispozitivi i vendimit. Në pjesën hyrëse janë përshkruar palët ndërgjyqëse, objekti i padisë dhe baza ligjore. Pjesa arsyetuese është e ndarë në dy nënpjesë. Në nënpjesën e parë përshkruese janë parashtruar *fakti dhe rrethanat* për kërkimet e palës paditëse lidhur me objektin e padisë dhe prapësimet e palës së paditur në nxjerrjen e akteve administrative objekt gjykimi. Po në këtë pjesë janë parashtruar nga ana e ndihmëses ligjore rrethanat e çështjes dhe provat e administruara në dosjen gjyqësore lidhur me gjobën e vendosur për mosdeklarim në organin tatimor të punonjësit të biletave për pasagjerët në një linjë urbane, duke u referuar për këtë tek e drejta e zbatueshme në këto raste. Në nënpjesën e dytë është përshkruar nga ana e ndihmëses ligjore *arsyetimi ligjor* dhe zgjidhja e çështjes për mosmarrëveshjen, ku janë analizuar kriteret ligjore për regjistrimin e personave të tatueshëm dhe procedura ligjore që ndiqet nga organet tatimore për verifikimet në vend. Ndihmësja ligjore ka arritur në përfundimin se kërkesa e paditësit është e bazuar në ligj e në prova, ajo duhet të pranohet dhe se nuk parashkruhet.

Përmenden dhe analizohen në arsyetim norma të ligjit nr. 49/2012, ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” dhe udhëzimet e Ministrisë së Financave. Ndihmësja ligjore ka përdorur në arsyetim norma procedurale dhe legjislative.

Nga pikëpamja e strukturës projektvendimi është i ndarë në paragrafë dhe tituj të evidentuar, sipas analizës së kërkimeve. Konstatohet se janë respektuar rregullat e drejtshkrimit, por nuk janë përdorur të gjitha karakteret e gjuhës shqipe. Fjalitë paraqiten në gjatësi normale dhe përmbajnë referenca ligjore. Teksti paraqitet i qartë dhe i kuptueshëm, në 6 faqe gjithsej. Projektvendimi është konceptuar nga subjekti i rivlerësimit, përmban në fund emrin dhe firmën e saj, por nuk pasqyron datën e përpilimit.

70. Përshkrimi i 5 dokumenteve ligjore të përzgjedhura me short

Dokumenti 1 – Çështja administrative nr. *** akti, datë 31.7.2015, që u përket palëve ndërgjyqëse: paditëse S. A kundër të paditurit Inspektorati Shtetëror i Punës, me objekt “Detyrimi për dëmshpërblim në masën 12 paga mujore për zgjidhje të menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës etj. ...”, e përfunduar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. ***, datë 2.10.2015.

Çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë më 31.7.2015, me nr. *** akti. Me shortimin e datës 1.9.2015, çështja i ka kaluar për shqyrtim gjyqtarës B. K.

Gjyqtarja B.K ka zhvilluar seancën përgatitore në datën 7.9.2015, duke vendosur në përfundim kalimin e çështjes në seancë gjyqësore. Pasi ka zhvilluar tri seanca gjyqësore, me vendimin nr.

***, datë 2.10.2015, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur: *“Rrëzimin e kërkesëpadisë të paraqitur nga pala paditëse S.A”*.

Rezulton se vendimi është ankimuar nga pala paditëse dhe Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. ***, datë 27.11.2018, ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 2.10.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë”*.

Gjykimi i çështjes ka zgjatur 1 muaj e 1 ditë, në periudhën 1.9.2015 – 2.10.2015, brenda afatit 6-mujor të caktuar nga pika 5, shkronja “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit.

Nga aktet e vëna në dispozicion nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, bazuar në nenin 6 të ligjit nr. 49/2012, rezulton se në dosjen gjyqësore:

- a) Nuk është përfshirë ndonjë akt që të dokumentojë ndihmën dhe këshillimin, që ndihmësja ligjore Enida Lamçe i ka dhënë gjyqtarës B.K lidhur me përgatitjen e çështjes për gjykim dhe shqyrtimin gjyqësor.
- b) Nuk është përfshirë përgatitja e ndonjë projektakti procedural të nevojshëm për gjykimin, që të mbajë nënshkrimin në cilësinë e konceptuesit prej ndihmësës ligjore Enida Lamçe.
- c) Nuk është përfshirë ndonjë kërkesë nga gjyqtarja B.K drejtuar ndihmësës ligjore për të bërë kërkime ligjore apo për të hartuar opinion me shkrim për problematika ligjore të karakterit procedural dhe material që lidhen me çështjen në fjalë. Rrjedhimisht, në dosje nuk rezulton i administruar ndonjë akt kërkimi ligjor apo opinion me shkrim nga vetë ndihmësja ligjore Enida Lamçe.

Sipas urdhrorit nr. **, datë 10.6.2015, të Kryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, rezultoi se në periudhën 10.6.2015 e në vazhdim znj. Enida Lamçe ka asistuar dhe ndihmuar gjyqtaret B.K dhe N.H.

Si rezultat, në kohën e dhënies së vendimit gjyqësor nr. ***, datë 2.10.2015, të sipërcituar, gjyqtarja B.K është asistuar nga ndihmësja ligjore Enida Lamçe. Pra, në hartimin, përpilimin e këtij vendimi gjyqësor, ka kontribuar me ndihmën e saj edhe subjekti i rivlerësimit si ndihmësë ligjore, duke hartuar “projektvendimin” në përputhje me udhëzimet e gjyqtarit përkatës.

Sigurish, projektvendimi në dosjen përkatëse nuk gjendet i hartuar nga subjekti i rivlerësimit Enida Lamçe, pasi aktet procedurale të dosjes duhet të nënshkruhen vetëm nga gjyqtari dhe jo nga ndihmësi. As neni 6, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, por asnjë dispozitë tjetër ligjore apo akt nënligjor nuk parashikon që në dosjen gjyqësore të përfshihen “projekta proceduralë” të përgatitura nga ndihmësi ligjor.

Gjithashtu, nuk rezulton që Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë në periudhën objekt rivlerësimi profesional (8.10.2013 – 8.10.2016) të ketë miratuar ndonjë rregullore me të cilën të normonte apo dokumentonte në njëfarë mënyre punën dhe asistencën e ndihmësve ligjorë që kanë ushtruar detyrën pranë asaj gjykate në atë periudhë.

Dokumenti 2 – Çështja administrative nr. *** akti, datë 10.3.2015, që u përket palëve ndërgjyqëse: paditës “K” sh.p.k. kundër të paditurit Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave Qarku Dibër, me objekt “Shfuqizimi i aktit administrativ, vendim për dënim administrativ me nr. **, datë 26.12.2014, gjobë në masën 500.000 lekë”, e përfunduar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. ***, datë 29.6.2015.

Çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë në datën 10.3.2015, me nr. *** regjistri themeltar. Me shortimin e datës 11.3.2015, çështja i ka kaluar për shqyrtim gjyqtarës B.K.

Gjyqtarja B.K ka zhvilluar dy seanca përgatitore në datat 13.3.2015 dhe 4.5.2015, duke vendosur në përfundim kalimin e çështjes në seancë gjyqësore. Pasi ka zhvilluar gjashtë seanca gjyqësore, me vendimin nr. ***, datë 29.6.2015, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur: *“Pranimin e kërkesëpadisë së palës paditëse “K” sh.p.k. Shfuqizimin e aktit administrativ të vendimit nr. **, datë 26.12.2015, të marrë nga Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave të Qarkut Dibër për vendosjen e gjobës në masën 500.000 lekë ndaj paditësit “K” sh.p.k.”.*

Gjykimi i çështjes ka zgjatur 3 muaj e 18 ditë në periudhën 11.3.2015 – 29.6.2015, brenda afatit 6-mujor të caktuar nga pika 5, shkronja “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit.

Nga aktet e vëna në dispozicion nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe në bazë të nenit 6 të ligjit nr. 49/2012, në dosjen gjyqësore rezultojnë se:

- a) Nuk është përfshirë ndonjë akt që të dokumentojë ndihmën dhe këshillimin, që ndihmësja ligjore Enida Lamçe i ka dhënë gjyqtarës B.K lidhur me përgatitjen e çështjes për gjykim dhe shqyrtimin gjyqësor.
- b) Nuk është përfshirë përgatitja e ndonjë projektakti procedural të nevojshëm për gjykimin, që të mbajë nënshkrimin në cilësinë e konceptuesit prej ndihmëses ligjore Enida Lamçe.
- c) Nuk është përfshirë ndonjë kërkesë nga gjyqtarja B.K drejtuar ndihmëses ligjore për të bërë kërkime ligjore apo për të hartuar opinion me shkrim për problematika ligjore të karakterit procedural dhe material, që lidhen me çështjen në fjalë. Rrjedhimisht, në dosje nuk rezultojnë i administruar ndonjë akt kërkimi ligjor apo opinion me shkrim nga vetë ndihmësja ligjore Enida Lamçe.

Sipas urdhrit nr. **, datë 10.6.2015, të Kryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, rezultoi se në periudhën 10.6.2015 e në vazhdim znj. Enida Lamçe ka asistuar dhe ndihmuar gjyqtaret B.K dhe N.H.

Si rezultat, në kohën e dhënies së vendimit gjyqësor nr. ***, datë 29.6.2015, të sipërcituar, gjyqtarja B.K është asistuar nga ndihmësja ligjore Enida Lamçe. Pra, në hartimin, përpilimin e këtij vendimi gjyqësor, ka kontribuar me ndihmën e saj edhe subjekti i rivlerësimit si ndihmëse ligjore, duke hartuar projektvendimin në përputhje me udhëzimet e gjyqtarit përkatës.

Sigurisht, projektvendimi në dosjen përkatëse nuk gjendet i hartuar nga subjekti i rivlerësimit Enida Lamçe, pasi aktet procedurale të dosjes duhet të nënshkruhen vetëm nga gjyqtari dhe jo nga ndihmësi. As neni 6, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, por asnjë dispozitë tjetër ligjore apo akt nënligjor nuk parashikon që në dosjen gjyqësore të përfshihen projektakte procedurale të përgatitura nga ndihmësi ligjor.

Gjithashtu, nuk rezultojnë që Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë në periudhën objekt rivlerësimi profesional (8.10.2013 – 8.10.2016) të ketë miratuar ndonjë rregullore me të cilën të normonte apo dokumentonte në njëfarë mënyre punën dhe asistencën e ndihmësve ligjorë që kanë ushtruar detyrën pranë asaj gjykate në atë periudhë.

Dokumenti 3 – Çështja administrative nr. *** akti, datë 25.3.2016, që u përket palëve ndërgjyqëse: paditës I.Gj kundër të paditurit Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, me objekt “Shfuqizimi i akteve administrative të vendimit nr. **, datë 1.2.3016, të Komisionit të Disiplinës të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve etj.”, e përfunduar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. ***, datë 25.5.2016.

Çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë më 25.3.2016, me nr. *** akti. Me shortimin e datës 29.3.2016, çështja i ka kaluar për shqyrtim gjyqtarës N. H.

Gjyqtarja N. H pasi ka zhvilluar dy seanca përgatitore ka vendosur në përfundim kalimin e çështjes në seancë gjyqësore. Pasi ka zhvilluar seancën gjyqësore, me vendimin nr. ***, datë 25.5.2016, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur: *“Pranimin e kërkesëpadisë.*

*Shfuqizimin e aktit administrativ të vendimit nr. **, datë 1.2.2016, “Largim nga shërbimi civil” për paditësin I.Gj të lëshuar nga Komisioni i Disiplinës së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.*

Detyrimin e palëve të paditura të rikthejnë paditësin I. Gj në vendin e mëparshëm të punës si Inspektor i dytë në Sektorin e Kontrollit Tatimor në Drejtorinë Rajonale Tiranë.

Detyrimin e palëve të paditura të paguajnë paditësit I. Gj pagën nga data e ndërprerjes së marrëdhënieve financiare deri në rikthimin në punë të paditësit”.

Gjykimi i çështjes ka zgjatur 1 muaj e 29 ditë, në periudhën 29.3.2016 – 25.5.2016, brenda afatit 6-mujor të caktuar nga pika 5, shkronja “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit.

Nga aktet e vëna në dispozicion nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe në bazë të nenit 6 të ligjit nr. 49/2012, në dosjen gjyqësore rezultojnë se:

- a) Nuk është përfshirë ndonjë akt që të dokumentojë ndihmën dhe këshillimin, që ndihmësja ligjore Enida Lamçe i ka dhënë gjyqtarës N.H lidhur me përgatitjen e çështjes për gjykim dhe shqyrtimin gjyqësor.
- b) Nuk është përfshirë përgatitja e ndonjë projektakti procedural të nevojshëm për gjykimin, që të mbajë nënshkrimin në cilësinë e konceptuesit prej ndihmësës ligjore Enida Lamçe.
- c) Nuk është përfshirë ndonjë kërkesë nga gjyqtarja N.H drejtuar ndihmësës ligjore për të bërë kërkime ligjore apo për të hartuar opinion me shkrim për problematika ligjore të karakterit procedural dhe material, që lidhen me çështjen në fjalë. Rrjedhimisht, në dosje nuk rezultojnë i administruar ndonjë akt kërkimi ligjor apo opinion me shkrim nga vetë ndihmësja ligjore Enida Lamçe.

Sipas urdhrit nr. **, datë 10.6.2015, të Kryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, rezultoi se në periudhën 10.6.2015 e në vazhdim znj. Enida Lamçe ka asistuar dhe ndihmuar gjyqtaret B.K dhe N.H.

Si rezultat, në kohën e dhënies së vendimit gjyqësor nr. ***, datë 25.5.2016, të sipërcituar, gjyqtarja N.H është asistuar nga ndihmësja ligjore Enida Lamçe. Pra, në hartimin, përpilimin e këtij vendimi gjyqësor, ka kontribuar me ndihmën e saj edhe subjekti i rivlerësimit si ndihmësë ligjore, duke hartuar projektvendimin në përputhje me udhëzimet e gjyqtarit përkatës.

Sigurisht, projektvendimi në dosjen përkatëse nuk gjendet i hartuar nga subjekti i rivlerësimit Enida Lamçe, pasi aktet procedurale të dosjes duhet të nënshkruhen vetëm nga gjyqtari dhe jo nga ndihmësi. As neni 6, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, por asnjë dispozitë tjetër ligjore apo akt nënligjor nuk parashikon që në dosjen gjyqësore të përfshihen projektakte procedurale të përgatitura nga ndihmësi ligjor.

Gjithashtu, nuk rezulton që Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë në periudhën objekt rivlerësimi profesional (8.10.2013 – 8.10.2016) të ketë miratuar ndonjë rregullore me të cilën të normonte apo dokumentonte në njëfarë mënyre punën dhe asistencën e ndihmësve ligjorë që kanë ushtruar detyrën pranë asaj gjykate në atë periudhë.

Dokumenti 4 – Çështja administrative nr. *** akti, datë 13.6.2016, që u përket palëve ndërgjyqëse: paditës “B” sh.p.k. kundër të paditurit Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, person i tretë zyra e përmbarimit “K.B.S” sh.p.k., me objekt “Konstatimi i pavlefshmërisë absolute të titullit ekzekutiv, vendimit për gjobë me nr. 1***, datë 2.4.2014, të Inspektoratit...”, e përfunduar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. ***, datë 20.7.2016.

Çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë në datën 13.6.2016, me nr. *** akti. Me shortimin e datës 14.6.2016, çështja i ka kaluar për shqyrtim gjyqtarës N.H.

Gjyqtarja N. H ka zhvilluar dy seanca përgatitore, duke vendosur në përfundim kalimin e çështjes në seancë gjyqësore. Pasi ka zhvilluar seancën gjyqësore, me vendimin nr. ***, datë 20.7.2016, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur: *“Pranimin e kërkesëpadisë. Deklarimin të pavlefshëm të titullit ekzekutiv, vendim gjobe nr. ***, datë 2.4.2014, të palës së paditur Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial”*.

Gjykimi i çështjes ka zgjatur 1 muaj e 6 ditë, në periudhën 14.6.2016 – 20.7.2016, brenda afatit 6-mujor të caktuar nga pika 5, shkronja “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit.

Nga aktet e vëna në dispozicion nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe në bazë të nenit 6 të ligjit nr. 49/2012, në dosjen gjyqësore rezulton se:

- a) Nuk është përfshirë ndonjë akt që të dokumentojë ndihmën dhe këshillimin, që ndihmësja ligjore Enida Lamçe i ka dhënë gjyqtarës N.H lidhur me përgatitjen e çështjes për gjykim dhe shqyrtimin gjyqësor.
- b) Nuk është përfshirë përgatitja e ndonjë projektakti procedural të nevojshëm për gjykimin, që të mbajë nënshkrimin në cilësinë e konceptuesit prej ndihmësës ligjore Enida Lamçe.
- c) Nuk është përfshirë ndonjë kërkesë nga gjyqtarja N.H drejtuar ndihmësës ligjore për të bërë kërkime ligjore apo për të hartuar opinion me shkrim për problematika ligjore të karakterit procedural dhe material, që lidhen me çështjen në fjalë. Rrjedhimisht, në dosje nuk rezulton i administruar ndonjë akt kërkimi ligjor apo opinion me shkrim nga vetë ndihmësja ligjore Enida Lamçe.

Sipas urdhrit nr. **, datë 10.6.2015, të Kryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, rezultoi se në periudhën 10.6.2015 e në vazhdim znj. Enida Lamçe ka asistuar dhe ndihmuar gjyqtaret B.K dhe N.H.

Si rezultat, në kohën e dhënies së vendimit gjyqësor nr. ***, datë 20.7.2016, të sipërcituar, gjyqtarja N.H është asistuar nga ndihmësja ligjore Enida Lamçe. Pra, në hartimin, përpilimin e këtij vendimi gjyqësor, ka kontribuar me ndihmën e saj edhe subjekti i rivlerësimit si ndihmëse ligjore, duke hartuar projektvendimin në përputhje me udhëzimet e gjyqtarit përkatës.

Sigurisht, projektvendimi në dosjen përkatëse nuk gjendet i hartuar nga subjekti i rivlerësimit Enida Lamçe, pasi aktet procedurale të dosjes duhet të nënshkruhen vetëm nga gjyqtari dhe jo nga ndihmësi. As neni 6, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, por asnjë dispozitë tjetër ligjore apo akt nënligjor nuk parashikon që në dosjen gjyqësore të përfshihen projektakte procedurale të përgatitura nga ndihmësi ligjor.

Gjithashtu, nuk rezulton që Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë në periudhën objekt rivlerësimi profesional (8.10.2013 – 8.10.2016) të ketë miratuar ndonjë rregullore me të cilën të normonte apo dokumentonte në njëfarë mënyre punën dhe asistencën e ndihmësve ligjorë që kanë ushtruar detyrën pranë asaj gjykate në atë periudhë.

Dokumenti 5 – Çështja administrative nr. *** akti, datë 16.5.2016, që u përket palëve ndërgjyqëse: paditës A.H kundër të paditurit Bashkia Tiranë, me objekt “Shfuqizimi i shkresës nr. ***, datë 29.12.2015, për zgjidhjen e kontratës individuale të punës etj.”, e përfunduar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. ***, datë 4.7.2016.

Çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë në datën 16.5.2016, me nr. *** akti. Me shortimin e datës 17.5.2016, çështja i ka kaluar për shqyrtim gjyqtarës N.H.

Gjyqtarja N. H ka zhvilluar dy seanca përgatitore, duke vendosur në përfundim kalimin e çështjes në seancë gjyqësore. Pasi ka zhvilluar seancën gjyqësore, me vendimin nr. ***, datë 4.7.2016, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur: “*Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë.*

Detyrimin e palës së paditur t’i paguajë paditësit A. H një dëmshpërblim prej tetë muaj pagë, për shkak të zgjidhjes së menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës.

Detyrimin e palës së paditur t’i paguajë paditësit A. H një dëmshpërblim prej tre muaj pagë, për shkak të mosrespektimit të afatit të njoftimit në zgjidhjen e kontratës së punës.

Detyrimin e palës së paditur t’i paguajë paditësit A. H një dëmshpërblim prej dy muaj pagë për shkak të mosrespektimit të procedurës në zgjidhjen e kontratës së punës.

Detyrimin e palës së paditur t’i paguajë paditësit A. H shpërblimin për vjetërsi në punë prej katër muaj pagë.

Rrëzimin e kërkesëpadisë për pjesën tjetër, si të pabazuar në ligj dhe në prova”.

Gjykimi i çështjes ka zgjatur 1 muaj e 17 ditë, në periudhën 17.5.2016 – 4.7.2016, brenda afatit 6-mujor të caktuar nga pika 5, shkronja “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit.

Nga aktet e vëna në dispozicion nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe në bazë të nenit 6 të ligjit nr. 49/2012, në dosjen gjyqësore rezulton se:

- a) Nuk është përfshirë ndonjë akt që të dokumentojë ndihmën dhe këshillimin, që ndihmësja ligjore Enida Lamçe i ka dhënë gjyqtarës N.H lidhur me përgatitjen e çështjes për gjykim dhe shqyrtimin gjyqësor.

- b) Nuk është përfshirë përgatitja e ndonjë projektakti procedural të nevojshëm për gjykimin, që të mbajë nënshkrimin në cilësinë e konceptuesit prej ndihmëses ligjore Enida Lamçe.
- c) Nuk është përfshirë ndonjë kërkesë nga gjyqtarja N.H drejtuar ndihmëses ligjore për të bërë kërkime ligjore apo për të hartuar opinion me shkrim për problematika ligjore të karakterit procedural dhe material, që lidhen me çështjen në fjalë. Rrjedhimisht, në dosje nuk rezultoi i administruar ndonjë akt kërkimi ligjor apo opinion me shkrim nga vetë ndihmësja ligjore Enida Lamçe.

Sipas urdhrin nr. **, datë 10.6.2015, të Kryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, rezultoi se në periudhën 10.6.2015 e në vazhdim znj. Enida Lamçe ka asistuar dhe ndihmuar gjyqtaret B.K dhe N.H.

Si rezultat, në kohën e dhënies së vendimit gjyqësor nr. ***, datë 4.7.2016, të sipërcituar, gjyqtarja N.H është asistuar nga ndihmësja ligjore Enida Lamçe. Pra, në hartimin, përpilimin e këtij vendimi gjyqësor, ka kontribuar me ndihmën e saj edhe subjekti i rivlerësimit si ndihmëse ligjore, duke hartuar projektvendimin në përputhje me udhëzimet e gjyqtarit përkatës.

Sigurisht, projektvendimi në dosjen përkatëse nuk gjendet i hartuar nga subjekti i rivlerësimit Enida Lamçe, pasi aktet procedurale të dosjes duhet të nënshkruhen vetëm nga gjyqtari dhe jo nga ndihmësi. As neni 6, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, por asnjë dispozitë tjetër ligjore apo akt nënligjor nuk parashikon që në dosjen gjyqësore të përfshihen projektakte procedurale të përgatitura nga ndihmësi ligjor.

Gjithashtu, nuk rezultoi që Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë në periudhën objekt rivlerësimi profesional (8.10.2013 – 8.10.2016) të ketë miratuar ndonjë rregullore me të cilën të normonte apo dokumentonte në njëfarë mënyre punën dhe asistencën e ndihmësve ligjorë që kanë ushtruar detyrën pranë asaj gjykate në atë periudhë.

71. Të dhëna nga burime arkivore të KLGJ-së lidhur me ankesa, masa disiplinore dhe vlerësime

71.1 Nga analiza e të dhënave të rezultuara nga përmbajtja e formularit të vetëvlerësimit, por edhe akteve të tjera pjesë e dosjes së vlerësimit, konstatohet se subjekti i rivlerësimit Enida Lamçe deri më sot nuk ka ushtruar asnjëherë funksionin e gjyqtarit pranë ndonjë gjykate të shkallës së parë apo apeli, prandaj për këtë subjekt nuk ka të dhëna në burimet arkivore të KLGJ-së për periudhën e rivlerësimit.

71.2 Si rezultat, të dhënat profesionale dhe etike për këtë subjekt janë marrë nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, ku znj. Enida Lamçe ka ushtruar detyrën si ndihmëse ligjore dhe rezultoi se nuk ka pasur masa disiplinore.

DENONCIME

72. Nga verifikimi i kryer nuk rezultojnë denoncime të regjistruara për subjektin e rivlerësimit Enida Lamçe.

Konkluzion i Komisionit për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

73. Pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga KLGJ-ja, trupi gjykues vëren se nuk mund të ngrihen dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e ndihmëses ligjore. Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, është eficient dhe efektive në masë të pranueshme dhe konsiderohet “e aftë” në aspektin profesional.

74. Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të shkronjës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

KONKLuzion PëRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatores së çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konkludon se subjekti:

- a. arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, referuar nenit 4, pika 2, nenit 58, pika 1, shkronja “a”, si dhe nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Enida Lamçe, ndihmëse ligjore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 31.5.2024.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Xhensila PINE
Kryesuese

Genta Tafa (BUNGO)
Relatore

Roland ILIA
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Etmonda Hoxha